



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 51

Qershor

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.263, datë 5.5.2006	Për miratimin e elementeve përbërëse të flamurit, uniformës dhe të shenjave, dalluese dhe identifikuese, të Policisë së Burgjeve dhe për përcaktimin e kriterëve të mbajtjes së tyre ...	3
Vendim i KM nr.275, datë 10.5.2006	Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurat e prokurimit të Bankës Botërore për objektet “Studimi i parafizibilitetit të Boshtit qendror – jugor” dhe “Supervizioni i punimeve të ndërtimit të rrugës Kalimash- Kukës-Morinë”	20
Vendim i KM nr.283, datë 17.5.2006	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të Drejtorit të Kompanisë Teatrore Shtetërore të Artit Dramatik (Teatri Kombëtar)	21
Vendim i KM nr.307, datë 24.5.2006	Për emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)	21
Vendim i KM nr.317, datë 31.5.2006	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të kryetarit të Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve	22
Vendim i KM nr.331, datë 2.6.2006	Për disa ndryshime në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave	22
Vendim i KM nr.341, datë 31.5.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën dhe pagat e punonjësve të Policisë së Ndërtimit”, të ndryshuar	27

VENDIM
Nr.263, datë 5.5.2006

**PËR MIRATIMIN E ELEMENTEVE PËRBËRËSE TË FLAMURIT,
UNIFORMËS DHE TË SHENJAVE, DALLUESE DHE IDENTIFIKUESE, TË POLICISË SË
BURGJEVE DHE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TE MBAJTJES SË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.8321, datë 2.4.1998, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e elementeve përbërëse të flamurit, emblemës, simbolit dhe të shenjës së Policisë së Burgjeve, sipas përcaktimeve të bëra në lidhjen nr. 1 dhe pasqyrimeve në album, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Miratimin e uniformës së Policisë së Burgjeve dhe të shenjave, dalluese dhe identifikuese, që mbahen në të, sipas kategorive të mëposhtme:

- a) Uniforma për punonjës të rolit madhor;
- b) Uniforma për punonjës të rolit të lartë;
- c) Uniforma për punonjës të rolit të mesëm;
- ç) Uniforma për punonjës të rolit bazë.
- i) Shërbimi,
- ii) Sigurie.

Elementet përbërëse të uniformës dhe shenjat, dalluese dhe identifikuese, të jenë sipas lidhjes nr.2 dhe pasqyrimeve në album, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Ministri i Drejtësisë, në zbatim të këtij vendimi, miraton:

a) normat e furnizimit me veshmbathje të punonjësve të Policisë së Burgjeve, sipas afateve kohore të përcaktuara;

b) shenjat dalluese, sipas shërbimeve të policisë, ornamentet dekorative e shtesa të tjera veshjeje për plotësimin e uniformës ceremoniale, me përjashtim të shenjës balllore, që vendoset në pjesën balllore të kapeles, shenjave të gjoksit, sipas roleve, gradave, stemës dhe simbolit të flamurit të Policisë së Burgjeve;

c) normat e materialeve të konsumit e të mirëmbajtjes, si dhe veshmbathjes së posaçme.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

5. Përdorimi i uniformës së re, për të gjitha kategoritë e punonjësve të Policisë së Burgjeve, të bëhet gradualisht nga hyrja në fuqi e këtij vendimi deri në fund të vitit 2006.

6. Vendimi nr.180, datë 6.3.1998, i Këshillit të Ministrave “Për uniformën e Policisë së Burgjeve”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ELEMENTET PËRBËRËSE TË FLAMURIT, EMBLEMËS, SIMBOLIT DHE SHËNJËS SË POLICISË SË BURGJEVE

ELEMENTET PËRBËRËSE TË FLAMURIT TË POLICISË SË BURGJEVE

Pjesa valëvitëse e flamurit

Pjesa valëvitëse e flamurit përbëhet nga një copë mëndafshi, me përmasa 100 cm x 70 cm, me sfond me ngjyrë blu të errët dhe me bordurë ngjyrë ari, në qendër të së cilës ndodhet shenja e Policisë së Burgjeve.

Pjesa jovalëvitëse e flamurit

Pjesa jovalëvitëse e flamurit përbëhet nga një shtizë cilindrike, me majë, me gjatësi 140 cm dhe me ngjyrë të argjentë.

EMBLEMA E POLICISË SË BURGJEVE

Emblema e Policisë së Burgjeve është e njëjtë me atë të Policisë së Shtetit dhe vendoset në kapele.

SIMBOLI I POLICISË SË BURGJEVE

Simboli i Policisë së Burgjeve është një beden kalaje me ngjyrë të artë e rrethuar me gjethe ulliri të vendosur mbi një sfond me ngjyrë të zezë.

SHENJA E POLICISË SË BURGJEVE

Shenja e Policisë së Burgjeve përbëhet nga stema zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë me ngjyrë të verdhë, e vendosur mbi një sfond me ngjyrë blu dhe me mbishkrimin “DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE”.

UNIFORMA E POLICISË SË BURGJEVE DHE SHENJAT DALLUESE DHE IDENTIFIKUESE TË SAJ DHE KRITERET E MBAJTJES SË TYRE

I. UNIFORMA PËR PUNONJËS TË ROLIT MADHOR

Uniforma për punonjës të rolit madhor të Policisë së Burgjeve është e njëjtë me atë të punonjësit të rolit të lartë dhe të mesëm dhe në të janë të vendosura elementët dekorativë, të cilët pasqyrojnë pozitën madhore në Policinë e Burgjeve.

II. UNIFORMA PËR PUNONJËS TË ROLIT TË MESËM DHE TË LARTË

Uniforma për punonjës të rolit të mesëm dhe të lartë të Policisë së Burgjeve është si më poshtë:

- Kostum stof terital ngjyrë blu i përbërë nga xhaketa, 2 palë pantallona me ngjyrën e xhaketës dhe 2 kapele.

Xhaketa ka në të dy cepat e jakës simbolin e Policisë së Burgjeve. Në krahun e majtë të xhaketës vendoset shenja e Policisë së Burgjeve dhe në krahun e djathtë flamuri kombëtar.

Në krahun e djathtë të gjoksit vendoset elementi dallues të identitetit të punonjësit të Policisë së Burgjeve.

Kostumi vishet me këmishë me mëngë të gjata me ngjyrë blu të errët dhe kollare ngjyrë blu.

Për raste ceremoniale kostumi vishet me këmishë të bardhë me mëngë të gjata.

Kapelja ka emblemën e Policisë dhe një shirit ngjyrë ari.

Pjesë e kësaj uniforme janë edhe këpucët gjysma me ngjyrë të zezë.

- Për stinën e dimrit vishet xhupi sintetik me kokore, ngjyrë blu me shenjën dalluese në krah, me veshje të ngrohtë nga brenda. Këpucët për këtë stinë janë me qafa me ngjyrë të zezë.

- Për stinën e verës uniforma përbëhet nga këmishë me mëngë të shkrutra ngjyrë blu, pa kollare dhe kopsa e parë e këmishës mbahet e hapur. Në krahun e majtë të këmishës vendoset shenja e Policisë së Burgjeve, në krahun e djathtë flamurin kombëtar. Pantallonat janë stof terital.

- Për stinën e vjeshtës shtohet një triko akrelik me jakë “V”, ngjyrë blu me mëngë të gjata me spaleta për grada.

- Për rastet e stërvitjes oficeri ka uniformën e përbërë nga një kostum doku, terikon poliestër, ngjyrë blu me xhakëtë, pantallona dhe kapele me strehë përpara. Këpucët për këto raste janë me kambale.

- Sipas stinëve kjo kategori punonjësish përfitojnë nga një bluzë pambuku me krahë të shkurtra dhe të gjata, doreza, çorape, rrip mesi dhe pantallonash.

III. UNIFORMA PËR PUNONJËSIT E ROLIT BAZË SHËRBIMI

Uniforma për punonjësit e rolit bazë shërbimi është si më poshtë:

- Kostumi dok, terikon e poliestër i përbërë nga xhaketa, 2 palë pantallona dhe kapele shapkë me strehë të gjatë. Ngjyra e kostumit është blu. Këpucët janë këpucë stërvitje me kambale.

- Për stinën e verës punonjësi i rolit bazë shërbimi do të ketë uniformën me pantallona doku terikon blu, këmishë me mëngë të shkurtra ngjyrë blu dhe këpucë me kambale. Nën veshje mbahet bluzë pambuku me mëngë të shkurtra.

- Për stinën e dimrit shtohet xhupi sintetik me kokore, triko akrelik, gjysëm golf me spaleta për grada me ngjyrë blu dhe një mushama shiu e gjatë.


- Uniforma ceremoniale e punonjësit të rolit bazë përbëhet nga kostumi stof blu, 2 kapele, 2 palë pantallona dhe një xhakëtë, këpucë gjysma, kravatë blu dhe këmishë me mëngë të gjata, të bardhë.

- Sipas stinëve këto kategori punonjësish të Policisë së Burgjeve përfitojnë nga një bluzë pambuku me krahë të shkurtra dhe të gjata, doreza, çorape, rrip mesi dhe pantallonash.

IV. UNIFORMA E PUNONJËSIT TË ROLIT BAZË TË SIGURISË

- Uniforma për punonjësit e rolit bazë të sigurisë është e njëjtë me uniformën e punonjësve të rolit bazë të shërbimit, duke shtuar një jelek pa mëngë dhe xhakavento, bluzë poliestër me tre komça, kapele beretë ngjyrë bojë qielli dhe kapuç akrelik ngjyrë blu.

Sipas stinëve kjo kategori punonjësish përfitojnë nga një bluzë pambuku me krahë të shkurtra dhe të gjata, doreza, çorape, rrip mesi dhe pantallonash.



FLAMURI I POLICISE SE BURGJEVE



SHENJA E KRAHUT E POLICISE SE BURGJEVE

UNIFORMAT
E POLICISE SE BURGJEVE

EMBLEMA TE KRAHU





**PUNONJES ROLI
MESEM, LARTE
UNIFORME CEREMONIALE**



**PUNONJES ROLI BAZE
UNIFORME CEREMONIALE**



**PUNONJESE ROLI BAZE
UNIFORME VERORE**



**PUNONJESE ROLI BAZE
UNIFORME VERORE**




**PUNONJESE ROLI BAZE
UNIFORME DIMERORE**



**PUNONJESE ROLI BAZE
UNIFORME DIMERORE**




**PUNONJESE ROLI BAZE
DETYRE**



**PUNONJESE ROLI BAZE
DETYRE**



**PUNONJES ROLI BAZE
(SIGURIE),
UNIFORME CEROMONIALE**



**PUNONJES ROLI BAZE
(SIGURIE),
UNIFORME CEROMONIALE**



**PUNONJES ROLI BAZE
(SIGURIE DETYRE),**



**PUNONJES ROLI BAZE
(SIGURIE DETYRE),**



**PUNONJES ROLI BAZE
(SIGURIE),
UNIFORME DIMERORE**



**PUNONJES ROLI BAZE
(SIGURIE),
UNIFORME DIMERORE**



**PUNONJES ROLI BAZE
(SIGURIE),
UNIFORME VERORE**



**PUNONJES ROLI BAZE
(SIGURIE),
UNIFORME VERORE**

UNIFORMA E POLICISE SE BURGJEVE





**PUNONJES ROLI BAZE
(SIGURIE, SITUATE),**



**PUNONJES ROLI BAZE
(SIGURIE, SITUATE),**

VENDIM
Nr.275, datë 10.5.2006

**PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RRUGËVE TË PËRDORË
PROCEDURAT E PROKURIMIT TË BANKËS BOTËRORE PËR OBJEKTET “STUDIMI I
PARAFIZIBILITETIT TË BOSHTIT QENDROR – JUGOR” DHE “SUPERVIZIONI I
PUNIMEVE TË NDËRTIMIT TË RRUGËS KALIMASH- KUKËS-MORINË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 3 e 17 pika 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006” me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurat e prokurimit të Bankës Botërore “Zgjedhja dhe punësimi i konsulentëve të huamarrësve të Bankës Botërore, publikuar në maj të vitit 2004, duke përdorur metodën e analizës së cilësisë dhe kostos (QCBS)”, për objektet e mëposhtme:

a) “Studimi i parafizibilitetit të boshtit Qendror-Jugor, me vlerë të plotë 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë nga të cilat: 4 000 000 (katër milionë) lekë janë programuar në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, zëri “Studim-projekte”, ndërsa diferenca të programohet në buxhetin shtesë të vitit 2006 për këtë ministri në zbatim të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”.

b) “Supervizioni i punimeve të ndërtimit të rrugës Kalimash-Kukës-Morinë”, me vlerë të plotë 160 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekë. Financimi të bëhet në përputhje me ecurinë e investimeve.

Studimi i parafizibilitetit të boshtit Qendror-Jugor të përfundojë brenda vitit 2006.

Kohëzgjatja e supervizionit të punimeve të ndërtimit të rrugës Kalimash-Kukës-Morinë të jetë në varësi të kontratave të punimeve të ndërtimit.

Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.283, datë 17.5.2006

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË KOMPANISË
TEATRORE SHTETËRORE TË ARTIT DRAMATIK (TEATRI KOMBËTAR)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31 të ligjit nr.8578, datë 10.2.2000 “Për teatrin”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lirimin e z. Kiço Londo nga detyra e drejtorit të Kompanisë Teatrore Shtetërore të Artit Dramatik (Teatri Kombëtar).
 2. Emërimin e z. Armando Bora drejtor të Kompanisë Teatrore Shtetërore të Artit Dramatik (Teatri Kombëtar).
 3. Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.307, datë 24.5.2006

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË SË
LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE
INFORMALE (ALUIZNI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z.Shaban Memia emërohet drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.317, datë 31.5.2006

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË KRYETARIT TË KËSHILLIT TË
AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lirimin nga detyra të z.Asllan Shera, kryetar i Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.

2. Emërimin e zj.Ermela Guxholli kryetar i Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.331, datë 2.6.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR ZBATIMIN E KODIT RRUGOR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.153, DATË 7.4.2000
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 99 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “d” e pikës 1 të nenit 248, pjesa III “Dokumente për qarkullimin dhe regjistrimin”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) Targat e mjeteve të trupit diplomatik: sfondi i bardhë, shkronjat dhe numrat të gjelbra. Shenja dalluese CD (Corpus Diplomaticum) (Figura III 4d/1.a dhe figura III 4d/2.a).”.

2. Në shtojcën X, neni 245, shkronjat “ë” dhe “g” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“ë) Targa e mjeteve të trupit diplomatik mban, sipas radhës, emblemën e flamurit kombëtar, dy karaktere alfabetike “CD”, dy karaktere numerike, vijë lidhëse dhe tri karaktere numerike. Për motomjetet mban dy karaktere alfabetike “CD”, emblemën e flamurit kombëtar, një karakter alfabetik dhe tri karaktere numerike (figura III 4h/1).”.

“g) Targa e mjeteve të shërbimit të trupit diplomatik mban, sipas radhës, emblemën e flamurit kombëtar, dy karaktere alfabetike “TR”, dy karaktere numerike, vijë lidhëse dhe dy karaktere numerike. Për motomjetet mban dy karaktere alfabetike “TR”, emblemën e flamurit kombëtar, një karakter alfabetik dhe tri karaktere numerike (figura III 4h/2).”.

3. Tabelat “Figura III 4d/1.a”, “Figura III 4d/2.a”, “Figura III 4h/1” dhe “Figura III 4h/2” zëvendësohen me tabelat me të njëjtin emërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Tabelat “Figura III 4d/1.b” dhe “Figura III 4d/2.b” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha




fig. III 4 d/1.a




fig. III 4d/2.a




fig. III 4h/1




fig. III 4h/2

VENDIM
Nr.341, datë 31.5.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.440, DATË 9.9.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË
NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Policia e Ndërtimit funksionon në varësi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Struktura e saj përbëhet nga drejtoria me qendër në Tiranë, dhe 15 degë, të organizuara në rrethe, 9 prej të cilave janë degë të kategorisë së parë dhe 6 janë degë të kategorisë së dytë, sipas lidhjeve nr.1 e nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.”.

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Policisë së Ndërtimit është 275 veta.”.


2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet më datë 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRUKTURA ORGANIKE E POLICISE SE NDERTIMIT NE QENDER DHE NE RRETHE

Nr.	DEGA	Drejtor	Zv/Drejtor	Kryetar Dege	Shf Sektori	spec finance	Spec teknik	Spec jurist	Specialist audit	Spec. marredh. Publik	Shf armatimi	Komandant gr. Spec	specialist gr. Special	zedhenes shtypi	Sekretare	shofer	Dezhurn	Arshiv Protokoll	Magazine	Pastruese	Shuma
1	Drejtoria	1	1	5		2	8	4	2	3	1	2	14	1	1	6	1	1	1	1	55
2	Tirana Qytet K1			1	3	1	14	3				1	6			4		1	1	1	36
3	Tirana Rreth K1			1		1	6	1				1	6			2					18
4	Durres K1			1		1	6	1				1	5			1					16
5	Fier K1			1		1	6	1				1	4			1					15
6	Vlore K1			1		1	8	1				1	4			1					17
7	Gjirokastr K2			1		1	4	1					2			1					10
8	Sarande K2			1		1	4	1					2			1					10
9	Elbasan K1			1		1	4	1				1	4			1					13
10	Berat K2			1		1	4	1					2			1					10
11	Shkoder K1			1		1	6	1				1	4			1					15
12	Kukes K2			1		1	4	1					2			1					10
13	Diber K2			1		1	4	1					2			1					10
14	Lezhe K1			1		1	6	1				1	4			1					15
15	Kavaja K2			1		1	4	1					2			1					10
16	Korce K1			1		1	6	1				1	4			1					15
Shuma		1	1	20	3	17	94	21	2	3	1	11	67	1	1	25	1	2	2	2	275



Fondi i Pagave & Sigurime Shoqerore(Shtesat)

Per nje muaj per 90 punonjes shtese nevojiten	3,734,375.0
Per Shtate muaj per 90 punonjes Fondi Pages shtese	28,000,000.0
Per sigurime shoqerore Shtese	8,596,000.0

Pozicioni	Per Person			Gjendja Aktuale		
	Paga Muiore Baza	Shitesat	Paga Bruto muiore	Nr Punonje	Shuma Muiore	
Drejtor	74,345.0	37,172.5	111,517.5	1	111,517.5	
Zv/Drejtor	55,422.0	27,711.0	83,133.0	1	83,133.0	
Kryetar Dege K1	28,000.0	23,800.0	51,800.0	10	518,000.0	
Kryetar Dege K2	26,000.0	22,100.0	48,100.0	6	288,600.0	
Kryetar Dege audit	28,000.0	28,000.0	56,000.0	0	0.0	
Kryetar Dege Finance	28,000.0	19,600.0	47,600.0	1	47,600.0	
Kryetar Dege Personeli	28,000.0	19,600.0	47,600.0	1	47,600.0	
Shef Sektori	26,000.0	22,100.0	48,100.0	5	240,500.0	
spec finance Drejtori	26,000.0	16,900.0	42,900.0	1	42,900.0	
spec finance Dege	23,500.0	15,275.0	38,775.0	14	542,850.0	
Spec teknik Drejtori	26,000.0	22,100.0	48,100.0	7	336,700.0	
Spec teknik Dege	23,500.0	16,450.0	39,950.0	56	2,237,200.0	
Spec jurist Drejtori	26,000.0	22,100.0	48,100.0	3	144,300.0	
Spec jurist Dege	23,500.0	19,975.0	43,475.0	11	478,225.0	
Specialist audit	26,000.0	26,000.0	52,000.0	1	52,000.0	
Specialist marredhenie me publikun	26,000.0	22,100.0	48,100.0	3	144,300.0	
Shef armatimi	28,000.0	23,800.0	51,800.0	0	0.0	
Specialist armatimi	26,000.0	14,300.0	40,300.0	1	40,300.0	
Komandant gr. Special Drejtori	28,000.0	23,800.0	51,800.0	1	51,800.0	
Komandant gr. Special Dege	26,000.0	22,100.0	48,100.0	5	240,500.0	
Specialist gr. Special	21,800.0	18,530.0	40,330.0	27	1,088,910.0	
Sekretare	15,000.0	12,750.0	27,750.0	1	27,750.0	
zedhenes shtypi	26,000.0	22,100.0	48,100.0	0	0.0	
shofer	21,000.0	17,850.0	38,850.0	22	854,700.0	
Dezhurn	15,000.0	12,750.0	27,750.0	1	27,750.0	
Arshiv Protokoll	15,000.0	9,750.0	24,750.0	2	49,500.0	
Magazine	15,000.0	9,750.0	24,750.0	2	49,500.0	
Pastruese	11,800.0	7,670.0	19,470.0	2	38,940.0	
Totali				185	7,735,075.5	

Pas Ndryshimit		Shtesat	
Nr Punonje	Shuma Mujore	Nr Punonje	Shuma Mujore
1	111,517.5	0	0.0
1	83,133.0	0	0.0
11	569,800.0	1	51,800.0
6	288,600.0	0	0.0
1	56,000.0	1	56,000.0
1	47,600.0	0	0.0
1	47,600.0	0	0.0
3	144,300.0	-2	-96,200.0
2	85,800.0	1	42,900.0
15	581,625.0	1	38,775.0
8	384,800.0	1	48,100.0
86	3,435,700.0	30	1,198,500.0
4	192,400.0	1	48,100.0
17	739,075.0	6	260,850.0
2	104,000.0	1	52,000.0
3	144,300.0	0	0.0
1	51,800.0	1	51,800.0
0	0.0	-1	-40,300.0
2	103,600.0	1	51,800.0
9	432,900.0	4	192,400.0
67	2,702,110.0	40	1,613,200.0
1	27,750.0	0	0.0
1	48,100.0	1	48,100.0
25	971,250.0	3	116,550.0
1	27,750.0	0	0.0
2	49,500.0	0	0.0
2	49,500.0	0	0.0
2	38,940.0	0	0.0
275	11,519,450.5	90	3,734,375.0

Nr.		DEGA	Shpenzime Operative			
			Kancelari	shpenz. Makine	Dieta	Karburant, vaj
1		Drejtoria	600,000.0	1,200,000.0	3,000,000.0	2,000,000.0
2		Tirana Qytet	300,000.0	400,000.0		600,000.0
3		Tirana Rreth.	100,000.0	100,000.0		36,000.0
4		Durres	200,000.0	200,000.0	50,000.0	100,000.0
5		Fier	200,000.0	200,000.0	60,000.0	100,000.0
6		Vlore	500,000.0	200,000.0	60,000.0	100,000.0
7		Gjirokaster	200,000.0	200,000.0	72,000.0	50,000.0
8		Sarande	160,000.0	100,000.0	72,000.0	100,000.0
9		Elbasan	75,000.0	100,000.0	72,000.0	200,000.0
10		Berat	150,000.0	150,000.0	60,000.0	100,000.0
11		Shkoder	200,000.0	200,000.0	60,000.0	200,000.0
12		Kukes	100,000.0	100,000.0	70,000.0	100,000.0
13		Diber	100,000.0	100,000.0	70,000.0	100,000.0
14		Lezhe	100,000.0	200,000.0	71,000.0	100,000.0
15		Kavaja	0.0	0.0	0.0	2,100,000.0
16		Korce	150,000.0	100,000.0	12,000.0	100,000.0
			3,135,000.0	3,550,000.0	3,729,000.0	6,086,000.0
			16,500,000.0			
			Shpenzime te tjera Administrative 3,500,000.0			
			Totali Operative 20,000,000.0			

INVESTIME

Nr.	Tavolina	Ndertesa	Fotokopje	Kompjuter	Faks	Dollap
1	Drejtoria			255,000.0	25,000.0	60,000.0
2	Tirana qyt		150,000.0	300,000.0		60,000.0
3	Tirana Rr.	135,000.0		150,000.0		60,000.0
4	Durres			75,000.0		60,000.0
5	Fier		150,000.0	75,000.0	25,000.0	180,000.0
6	Vlore		150,000.0	75,000.0		60,000.0
7	Gjrokast	505,000.0		75,000.0		30,000.0
8	Sarande	44,000.0		75,000.0	25,000.0	30,000.0
9	Elbasan	66,000.0	150,000.0	75,000.0	25,000.0	30,000.0
10	Berat	66,000.0		75,000.0		30,000.0
11	Shkoder	88,000.0	150,000.0	75,000.0	25,000.0	60,000.0
12	Kukes	66,000.0		75,000.0	25,000.0	30,000.0
13	Diber	110,000.0		75,000.0	25,000.0	30,000.0
14	Lezhe		150,000.0	75,000.0	25,000.0	
15	Kavaja	88,000.0	5,500,000.0	75,000.0	25,000.0	180,000.0
16	Korce	110,000.0	150,000.0	75,000.0	25,000.0	
	1,188,000.0	8,580,000.0	1,050,000.0	1,680,000.0	250,000.0	900,000.0

Karrige	Pajisje zyre	Radio dore	Apa fotograf
36,000.0	125,000.0	288,000.0	
30,000.0	40,000.0	144,000.0	25,000.0
15,000.0	20,000.0		25,000.0
45,000.0	20,000.0		25,000.0
30,000.0	40,000.0		25,000.0
15,000.0			
9,000.0	20,000.0		25,000.0
15,000.0			
21,000.0			
30,000.0	35,000.0		25,000.0
15,000.0			
15,000.0			
9,000.0			
30,000.0	50,000.0		25,000.0
15,000.0	40,000.0		25,000.0
330,000.0	390,000.0	432,000.0	200,000.0
Totali Investim			15,000,000.0

INVESTIME

Nr.	Ndertesa	Fotokopje	Kompiuter	Apa fotog	Radio dorc	Pajisje zyre
1	Drejtoria		255,000.0		288,000.0	85,000.0
2	Tirana qyt	150,000.0	300,000.0			331,000.0
3	Tirana Rr	135,000.0	150,000.0	25,000.0	144,000.0	240,000.0
4	Durres		75,000.0	25,000.0		95,000.0
5	Fier	150,000.0	75,000.0	25,000.0		380,000.0
6	Vlore	150,000.0	75,000.0	25,000.0		218,000.0
7	Gjrokast	505,000.0	75,000.0			177,000.0
8	Sarande		75,000.0	25,000.0		128,000.0
9	Elbasan	150,000.0	75,000.0			136,000.0
10	Berat		75,000.0			117,000.0
11	Shkoder	150,000.0	75,000.0	25,000.0		238,000.0
12	Kukes		75,000.0			136,000.0
13	Diber		75,000.0			180,000.0
14	Lezhe	150,000.0	75,000.0			34,000.0
15	Kavaja	5,500,000.0	75,000.0	25,000.0		373,000.0
16	Korce	2,440,000.0	75,000.0	25,000.0		190,000.0
8,580,000.0		1,050,000.0	1,680,000.0	200,000.0	432,000.0	3,058,000.0
					Totali Investim 15,000,000.0	

Makinerite

Makineria	Sasia	Cmimi	Totali
Cekic	1	3,000,000.0	3,000,000.0
Pince	1	4,000,000.0	4,000,000.0
Fadrome	3	10,000,000.0	30,000,000.0
Ekskavator Rrota	2	5,000,000.0	10,000,000.0
Trailer	1	9,000,000.0	9,000,000.0
Furgon	7	2,000,000.0	14,000,000.0
Autoveture	5	1,500,000.0	7,500,000.0
Paisje Teknologjike		5,000,000.0	5,000,000.0
Totali			82,500,000.0

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 4.6.2010

Doli nga shtypi më 6.6.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë